



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:283081

Datë: 07.03.2024

Numri i dokumentit: 05425889

**P.nr.1332/
23**

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Arlind Sharani, me procesmbajtësin Amar Hoxha, në çështjen penale kundër të akuzuarit E.N., nga fshati Lukinjë/Has, Komuna e Prizrenit, për shkak të veprave penale kanosja, nga neni 181 par. 4 lidhur me par. 2 të KPRK-së, dhe mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP/II.nr.996-7/2023, të datës 15.12.2023, pas mbajtjes së seancës publike për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë me datën 07.03.2024, në prezencën e prokurorit të shtetit Beqë Shala, mbrojtësit të viktimave A.A., të dëmtuarës A.G., të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij av. B.P., nga Prizreni, sipas autorizimit, në të njëjtën ditë mori, publikisht shpalli, dhe e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

E.N., nga i ati, e ëma, e gjinisë, i lindur me datënnë fshatin Lukinjë/Has, Komuna e Prizrenit, ku edhe tani banon, me punë të përkohshme në R. e Serbise, në fshatin Stepojova, në afërsi të Beogradit, i pamartuar – baba i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, furrtar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal:

Ë S H T Ë F A J T O R

I. Se më datë 27.03.2023 rreth orës 19:00 min në fshatin Lukinaj Komuna e Prizrenit, saktësisht në shtëpinë e tyre të përbashkët, i pandehuri seriozisht i kanoset personit tjetër me fjalë, vepra apo gjeste se do ta privojë nga jeta ose se do t'i shkaktojë lëndim të rëndë trupor, se do ta rrëmbejë ose privojë nga liria, bashkëshortes së tij, ashtu që nëpërmjet telefonit në rrejte sociale i pandehuri i kërkon të dëmtuarës - bashkëshortes së tij “ që të dal nga shtëpia, të marr fëmijët, nëse nuk del nga shtëpia do të vijë nga Beogradi dhe do të vras” tek bashkëshortja – e dëmtura ka shkaktuar frikë ankth dhe pasiguri për vete dhe fëmijët e saj.

Me këto veprime ka kryer veprën penale: Kanosja nga neni 181 par. 4 lidhur me par. 2 të KPRK-së.

II. Më datë, kohë dhe vend si në pikën I të këtij aktvendimi, posedon armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, në atë mënyrë që gjatë kontrollit të ushtruar nga Policia e Kosovës në vendin e ngjarjes – shtëpinë e të pandehurit, i është gjetë në posedim 1 (një) armë e zjarrit model “TT – M57” Zastava, me numër serik D – 2975 D dhe 39 (tridhjetë e nëntë) fishekë të kalibrit 7.62 mm, të cilat i kishte pas në posedim pa leje të organit kompetent.

Me këto veprime ka kryer veprën penale Mbjajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 8, 9, 10, 17 par.1, 38, 39, 40, 42, 43, 44, 69, 70. 181 par. 4 lidhur me par. 2 dhe nenit 366 par. 1 të KPRK-së, dhe 364 të KPP-së, të akuzuarin e:

G J Y K O N:

Për veprën penale kanosja nga neni 181 par. 4 lidhur me par. 2 të KPRK-së, nën I të dispozitivit të aktgjykimit, me **DËNIM ME BURGIM** prej 6 (gjashtë) muaji, i cili dënim me burgim konform nenit 44 të KPRK-së, me pëlqimin dhe kërkesën e të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, zëvendësohet **ME DËNIM ME GJOBË** në shumën prej 800€ (tetëqind euro).

Për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 366 par.1 të KPRK-së, nën II të dispozitivit të aktgjykimit, me **DËNIM ME GJOBË** në shumën prej 500€ (pesëqind euro).

Andaj, gjykata konform nenit 76 par.1 dhe par.2 nënpar.2.4 të KPRK-së, të akuzuarit ia shqipton:

DËNIMIN UNIK ME GJOBË në shumë prej 1300€ (njëmijë e treqind Euro), të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguajë në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, nëse i njëjti nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë gjobën, gjykata mund t’ia zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim, ashtu që 20€ (njëzet euro) nga dënimi me gjobë do të llogaritet barabartë me një ditë burgim.

Nga i akuzuari E.N., konform nenit 366 paragrafi 3 të KPRK-së, konfiskohet arma e zjarrit model “TT-M57” Zastava, me numër serik D-2975 D dhe 39 (tridhjetë e nëntë) fishekë të kalibrit 7.62mm, si objekt i veprës penale.

Urdhërohet Stacioni Policor në Prizren, që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi të bëjë shkatërrimin e armës dhe fishekët, që në polici evidentohen sipas numrit të rastit 2023-GA-550.

Detyrohet i akuzuari E.N., që t’i paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë për shpenzimet e paushallit gjyqësorë në shumën prej 20€ (njëzet euro), ndërsa për programin për

kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 20€ (njëzet euro), të gjitha këto në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara A.G., nga Prishtina, me vendbanim në rrugën “.....”, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate përkatësisht në Departamentit të Përgjithshëm me datën 15.12.2024, ka ngritur aktakuzën me numër PP/II.nr.996-7/2023, të datës 15.12.2023, kundër të akuzuarit E.N., nga fshati Lukinjë/Has, Komuna e Prizrenit, për shkak të veprave penale kanosja, nga neni 181 par. 4 lidhur me par. 2 të KPRK-së, dhe mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 366 par. 1 të KPRK-së dhe së bashku me aktakuzë është dorëzuar edhe marrëveshja për pranimin e fajësisë me numër PP/II.nr.996-7/2023, të datës 15.12.2023, e lidhur në mes të Prokurorisë Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm në njërën anë, si dhe të akuzuarit E.N., dhe mbrojtësit të tij av. B.P., në anën tjetër. Sipas kësaj marrëveshje gjykatës i është rekomanduar që ndaj të akuzuarit për shkak të veprave penale: kanosja, nga neni 181 par. 4 lidhur me par. 2 të KPRK-së, dhe mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, ti shqiptohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj i cili dënim konform nenit 44 të KPRK-së, t'i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumën prej 800€ (tetëqind euro) dhe dënim me gjobë në shumën prej 500€ (pesëqind euro), dhe për dy veprat të shqiptohet dënim unik me gjobë në shumën e përgjithshme prej 1300€ (njëmijë e treqind euro).

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë me datën 07.03.2024, në të cilën seancë është shqyrtuar marrëveshja për pranimin e fajësisë ku është dëgjuar i akuzuari E.N., Prokurori i shtetit Beqë Shala, e dëmtuara A.G., si dhe mbrojtësi i të akuzuarit av. B.P.,.

I akuzuari E.N., gjatë seancës për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë ka deklaruar se: marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë e ka nënshkruar personalisht pas konsultimeve mjaftueshme me mbrojtësin e tij, i kupton të gjitha pasojat e pranimit të fajësisë, e kupton faktin se me pranimin e fajësisë sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë heqë dorë nga e drejta në gjykim të rregullt si dhe të gjitha të drejtat që kanë të bëjnë me një gjykim të rregullt, e kupton aktakuzën përkatësisht veprën penale, e cila i vihet në barrë me aktakuzë dhe e pranon fajësinë për veprat penale që i vien në barrë, dhe ka shtuar se është penduar për veprimet e tij ndaj këtu të dëmtuarës, premtion gjykatës se veprimet ndaj këtu të dëmtuarës nuk do të ndodhin më.

Prokurori i shtetit Beqë Shala, gjatë seancës për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë ka deklaruar se: marrëveshja për pranim të fajësisë është lidhur vullnetarisht, pa presion nga ana e të pandehurit dhe prokurorit të shtetit ku prezent ka qenë edhe i mbrojturi i tij, e cila marrëveshje edhe nga kryeprokurori i shtetit dhe propozon që e njëjta marrëveshje të aprovojë në formën në të cilën është hartuar, me formën e dënimit që është propozuar në marrëveshje.

Mbrojtësi i viktimave A.A., gjatë seancës për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë ka deklaruar se: nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, e mbështet në tërësi deklaratën e prokurorit të shtetit, sa i përket kompensimit të dëmit, e dëmtuara parashtron kërkesë pasurore juridike, për lartësinë dhe vlerën e së cilës ia le në vlerësim gjykatës.

E dëmtuara A.G., gjatë seancës për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë kanë deklaruar se: pajtohet me deklaratën e mbrojtësit të viktimave dhe ka tjetër çka të shtoj.

Mbrojtësi i të akuzuarit av. B.P., gjatë seancës për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë ka deklaruar se: marrëveshja mbi pranimin e fajësisë është hartuar konform KPPRK-së, i mbrojturi i tij ka kuptuar natyrën e veprës penale, por të njëjtat ka shprehur pendesë dhe premtim se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprimet e njëjta, mbi këtë bazë propozon gjykatës që në tërësi të aprovohet marrëveshja si dhe dënim i rekomanduar në këtë marrëveshje. Propozohet që pagesa e gjobës të mundësohet në këste, pasi që i mbrojturi i tij është i pa punë dhe deri në rregullimin e marrëdhënies së punës i nevojitet një kohë e caktuar.

I akuzuari E.N., gjatë seancës për caktimin e dënimit ka deklaruar se: pajtohet me fjalët e mbrojtësit të tij, e lut gjykatën që të shqiptojë dënimin e rekomanduar në marrëveshje, për shkak të gjendjes së tij ekonomike.

2. Vlerësimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë

Në seancën publike për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë të mbajtur me datën 07.03.2024, pas shqyrtimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë të paraqitur nga Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti përgjithshëm, me numër PP/II.nr.996-7/2023, të datës 15.12.2023, e cila ka të bëjë me të akuzuarin E.N., për shkak të veprave penale: kanosja, nga neni 181 par. 4 lidhur me par. 2 të KPRK-së, dhe mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, si dhe deklarimit për pranimin e fajësisë të bërë nga i akuzuari në pajtim me dispozitat e nenit 230 par. 17 të KPP-së, Gjykata ka gjetur se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetshme pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij av. B.P., i akuzuari nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza. Gjithashtu gjykata ka konstatuar se në shkresat e lëndës ka prova të mjaftueshme që vërtetojnë faktin se i akuzuari ka kryer veprat penale me të cilën ngarkohet me aktakuzë dhe atë duke u bazuar në pranimin e fajësisë nga vet i akuzuari dhe marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë dhe si dhe në provat tjera të cilat i përmban aktakuza të cilat prova janë të mjaftueshme për të vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprat penale e cila i vihet në barrë, ku gjithashtu gjykata ka konstatuar se në shkresat e lëndës nuk ekziston asnjë rrethanë e paraparë me nenin 248 par.1 dhe 2 të KPP-së për pushimin e procedurës përkatësisht hedhjen e aktakuzës, prandaj gjykata pas dëgjimit të palëve dhe të mbrojtësit të të akuzuarit, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar marrëveshja mbi pranimin e fajësisë ka mbështetje ligjore dhe bazuar në nenin 230 par.20 të KPP-së të njëjtën e ka pranuar dhe ka vendosur në shkresat e lëndës.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

- se i akuzuari E.N., me dashje ka kryer veprat penale kanosja, nga neni 181 par. 4 lidhur me par. 2 të KPRK-së, dhe mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruara si në dispozitivin nën I dhe II të këtij Aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Sipas nenit 181 par.2 të KPRK-së, është parashikuar se formën e kualifikuar e veprës penale kanosje e që e kryen “*Kushdo që seriozisht e kanos personin tjetër me fjalë, vepra apo gjeste se do ta privojë nga jeta ose do të ‘i shkaktojë lëndime të rënda trupore, se do të rrëmbejë ose privojë nga lira ndonjë person tjetër ose se do të dëmtojë me armë zjarri, me shpërthim ose me mjete të tjera të rrezikshme*”. Ndërsa në paragrafin 4 të këtij neni është përcaktuar formë tjetër e kualifikuar me e rëndë e kësaj vepre penale që konsiderohet se kryhet ndaj viktimës së ndjeshme ose me përdorim të armës, mjetit të rrezikshëm ose ndonjë send tjetër me të cilin mund të shkaktohet lëndimi trupor ose dëmtimi i rëndë për shëndetin, ashtu që kryesi dënohet me burgim prej një (1) viti deri në pesë (5) vjet.

Në nenin 366 paragrafi 1 të KPRK-së, është parashikuar se këtë formë të kësaj vepre penale e kryen “*Kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në shkëlqje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet*”. Ndërsa, në Ligjin për armët, është parashikuar se për të mbajtur në posedim apo pronësi ndonjë armë, duhet që personi të ketë leje valide të lëshuar nga organi kompetent.

5. Vendimet e gjyqtarit të vetëm gjykues

Duke u bazuar në këto që janë cekur me lartë, gjyqtari i vetëm gjykues të akuzuarin E.N., e ka shpallur fajtor për veprat penale për të cilën është ngarkuar ngase në veprimet e të akuzuarit të përshkruara në dispozitiv të aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprave penale kanosja, nga neni 181 par. 4 lidhur me par. 2 të KPRK-së, dhe mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit ka vlerësuar se duhet të aprovohet rekomandimi i paraqitur në marrëveshjen për pranimin e fajësisë që ndaj të akuzuarit E.N., të shqiptohet dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ngase ka vlerësuar se duke i marrë për bazë të gjitha rrethanat e shënuara më poshtë, të cilat duke i ndërlidhur njëra me tjetrën janë vlerësuar rrethana në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarit me rastin e matjes së dënimit, gjyqtari i vetëm gjykues i ka marrë për bazë disa rrethana lehtësuese dhe një rrethanë posaçërisht lehtësuese. Prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: se është i gjendjes së dobët ekonomike, se është mbajtës i familjes, në gjykim ka pasur qëndrim tejet korrekt, pendimin e tij dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të këtilla, nuk do të kryej vepra penale, pra i njëjti ka pranuar që ka bërë diçka të keqe, i njëjti ka pranuar përgjegjësinë dhe është i gatshëm të korrigjojë atë. Për më tepër, si rrethana posaçërisht lehtësuese gjykata ka vlerësuar faktin se i akuzuari ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë me Prokurorinë

Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, i akuzuari ka bashkëpunuar me prokurorin e shtetit; se pranimin e fajësisë e ka bërë gjatë të gjitha fazave të procedurës penale, që sipas vlerësimit të gjykatës është pranim i përgjegjësishë dhe pendimi për kryerjen e veprave penale. Ndërsa, si rrethanë rënduese gjykata ka vlerësuar faktin se i njëjti edhe më parë ka qenë i dënuar me dënim me gjobë, me burg dhe dënim me kusht, sipas aktgjykimeve të plotfuqishëm: P.2158/2017, në Gjykatën Themelore në Prizren dhe Gjykatën Themelore në Prishtinë P.nr.3696/2023 dhe P.nr.5112/2017. Andaj duke pasur parasysh se i akuzuari e ka pranuar fajësinë sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, gjykata ka ardhur në përfundim se këto janë rrethana, që tregojnë me dënimin e shqiptuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi mund të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së dhe tek i akuzuari me të drejtë mund të pritët që në të ardhmen nuk do të kryejë ndonjë vepër tjetër penale dhe se dënimi i shqiptuara sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprat penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Zëvendësimi i dënimit me burgim në dënim me gjobë

Gjyqtari i vetëm gjykues, duke u bazuar në nenin 44 të KPRK-së, me kërkesën dhe pëlqimin e të akuzuarit dhe mbrojtësi të tij, dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaji, e ka zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë prej tetëqind euro (800€), duke i marr për bazë rrethanat e lartcekura.

8. Vendim për konfiskim

Vendimin mbi konfiskimin e sendeve është marrë në kuptim të nenit 267 par.2 nën par. 2.1 të KPPRK-së dhe 366 par. 3 të KPRK-së pasi që të njëjtat sende u vërtetua se janë mjet i kryerjes së veprës penale në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit si dhe provave të bashkëngjitura.

9. Vendimi lidhur me kërkesën pasurore juridike

Gjykata, duke u bazuar në nenin 462 paragrafi 2 të KPP, ka vendosur që të dëmtuarën, për realizimin e kërkesës pasurore juridike ta udhëzojë në kontest të rregullt juridiko civil, ngase, të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtë, të kërkesës pasurore juridike.

10. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 449 par.1 dhe 2 nën par. 2.6 lidhur me nenin 452 par. 1 të KPP-së, ndërsa për shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 36 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, komfor nenit 364 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal
P.nr.1332/2023 më datë 07.03.2024

Zyrtari ligjor
Amar Hoxha

Gjyqtari i vetëm gjykues
Arlind Sharani

UDHËZIMI JURIDIK: Ndaj këtij aktgjykimi palët nuk kanë të drejtën e ankesës për shkak të vendimit mbi dënimin dhe për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Ankesa për bazat e tjera mund të ushtrohet në afat prej 30 ditëve, prej ditës së marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes Gjykatës Themelore në Prizren.